



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 27 nëntor 2017
Nr. ref.: AGJ 1156/17

AKTGJYKIM

në

rastin nr. KI10/17

Parashtrues

Sadije Shabani

**Vlerësim i kushtetutshmërisë për mospërmbarimin e Vendimit të
Komisionit të Ankesave të Shërbyesve Civilë të Komunës së Skenderajt,
nr. 112-158/1, të 12 qershorit 2008**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Sadije Shabani (në tekstin e mëtejshëm: parashtruesja e kërkesës), me vendbanim në fshatin Tërnavc, komuna e Skenderajt, e përfaqësuar nga Safet Voca, avokat.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesja e kërkesës konteston kushtetutshmërinë e mospërmbarimit të Vendimit të Komisionit të Ankesave të Shërbyesve Civilë të Komunës së Skenderajt (në tekstin e mëtejme: KASHC-KK në Skenderajt), nr. 112-158/1, të 12 qershorit 2008 nga Komuna e Skenderajt dhe nga gjykatat e rregullta në procedurë përmbarimore.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë përkitazi me refuzimin Komunës së Skenderajt dhe të gjykatave të rregullta në procedurë përmbarimore për ta përmbaruar Vendimin e KSHAC-KK të Skenderajt, nr. 112-158/1, të 12 qershorit 2008. Si rezultat i mospërmbarimit të vendimit në fjalë parashtruesja pretendon shkeljen e të drejtave të saj të garantuara me nenin 24 [Barazia para Ligjit], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 46 [Mbrojtja e Pronës], nenin 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesioneve] dhe nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), si dhe nenin 6 [E Drejta për një proces të rregullt gjyqësor], në lidhje me nenin 13 [E drejta për zgjidhje efektive] të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: Konventa).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113, paragrafin (7) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 29 të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 8 shkurt 2017, parashtruesja e kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 20 mars 2017, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Selvete Gërxhaliu-Krasniqi gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Gresa Caka-Nimani.
7. Më 11 prill 2017, Gjykata e njoftoi përfaqësuesin e autorizuar të parashtrueses së kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe një kopje të kërkesës ia dërgoi Gjykatës Supreme.
8. Më 23 prill 2017, parashtruesja e kërkesës në Gjykatë, dorëzoi argumente shtesë.
9. Më 13 nëntor 2017, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin paraprak të gjyqtarës raportuese dhe i rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë që ta deklarojë kërkesën të pranueshme dhe të gjej shkelje nga neni 31 i Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të Konventës.

Përmbledhja e fakteve

Procedura administrative

10. Parashtruesja e kërkesës nga viti 2002 deri në vitin 2007, ka punuar si mësimdhënëse e lëndës mësimore edukata qytetare dhe të drejtat e njeriut në gjimnazin “Hamëz Jashari” në Skenderaj.
11. Në tetor 2007, Drejtoria Komunale e Arsimit e Komunës së Skenderajt (në tekstin e mëtejme: DKA në Skenderaj), parashtrueses së kërkesës ia ndërpreu marrëdhënien e punës.
12. Më 20 nëntor 2007, parashtruesja parashtrroi ankesë në Komisionin e Ankesave të Komunës së Skenderajt, për shkak se DKA-së në Skenderaj nuk kishte kthyer përgjigje në ankesën e saj, lidhur me mosvazhdimin e kontratës së punës.
13. Më 19 dhjetor 2007, Komisioni i Ankesave i Komunës së Skenderajt (Vendimi nr. 112-567), refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtrueses, duke u mbështetur në shkresat e lëndës dhe rekomandimin e drejtorit të gjimnazit “Hamëz Jashari” nr. 46, të 23 tetorit 2007, ku thuhej se “... për vitin 2007/08 janë paraparë 10 orë të lëndës edukata qytetare, të cilat i janë dhënë profesorit të historisë që kishte përvojë më të gjatë në atë shkollë”.
14. Më 14 janar 2008, parashtruesja e kërkesës parashtrroi ankesë (ankesa nr. 70/08) në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës (në tekstin e mëtejme: KPMK:), ndaj vendimit të 19 dhjetorit 2007 të Komisionit të Ankesave të Komunës së Skenderajt.
15. Më 11 mars 2008, KPMK-ja (Vendimi nr. 499/2008) vendosi: “I. Aprovohet pjesërisht ankesa nr.70/08 e datës 14.01.2008, parashtruar nga znj. Sadije Shabani; anulohet vendimi i Komisionit të Ankesave nr. 112-567 të datës 19.12.2007; ndërsa lënda kthehet në rishqyrtim në Komisionin e Ankesave në KK Skenderaj. II. Komisioni i KPMK-së konstatoi se gjatë formimit të Komisionit të Ankesave, janë shkelur parimet e Urdhërësës Administrative 2003/2, me nenin 33.2 dhe në nxjerrjen e vendimit ka konflikt interesi në përbërjen e komisionit (kryetarit) sipas nenit 29-29.3 të Urdhërësës Administrative 2003/2.”
16. Më 26 mars 2008, parashtruesja, në bazë të konstatimeve të KPMK-së, parashtrroi ankesë në KASHC-KK në Skenderaj, për kthim në punë.
17. Më 12 qershor 2008, KASHC-KK në Skenderaj (Vendimi nr. 112-158/1), aprovoi ankesën e parashtrueses dhe e obligoi DKA-në në Skenderaj, si në vijim: “II. Obligohet drejtoria Komunale e Arsimit që zonjën Sadije Shabani ta sistemojë në shërbimin e administratës.” Ky vendim mori formën e prerë 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas nxjerrjes së tij, pasi kundër tij nuk ishte ushtruar ankesë (në tekstin e mëtejme: Vendimi përfundimtar).
18. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesja ushtroi padi në Gjykatën Komunale në Skenderaj kundër DKA-së së Skenderajt, për shkak të mospërmbarimit të

vendimit përfundimtar, për kthim në punë dhe kompensim të pagave të papaguara.

19. Më 14 nëntor 2008, Gjykata Komunale në Skenderaj (Aktvendimi C. nr. 168/08), hodhi poshtë padinë e parashtrueses, duke arsyetuar se, sipas Rregullores nr. 2001/36 për Shërbimin Civil të Kosovës, kompetent për të vendosur për këtë çështje juridike është KPMK-ja.
20. Parashtruesja pohon se e ka njoftuar disa herë KPMK-në për mospërmbarimin e vendimit përfundimtar, por nuk mori asnjëherë përgjigje nga e njëjta.

Procedura përmbarimore

21. Më 11 dhjetor 2008, parashtruesja, në cilësinë e kreditores, parashtroi propozim për përmbarim të vendimit përfundimtar në Gjykatën Komunale në Skenderaj.
22. Më 8 shtator 2009, Gjykata Komunale në Skenderaj (Aktvendimi E. r. 46/2009), aprovoi propozimin e parashtrueses për përmbarim të vendimit përfundimtar.
23. DKA në Skenderaj, në cilësinë e debitorit, ushtroi kundërshtim në instancën e dytë të Gjykatës Komunale të Skenderajt kundër Aktvendimit të 8 shtatorit 2009 të instancës së parë të së njëjtës gjykatë.
24. Më 15 tetor 2009, instanca e dytë e Gjykatës Komunale në Skenderaj (Aktvendimi E. nr. 46/2009), refuzoi si të pabazuar kundërshtimin e DKA-së në Skenderaj dhe e konfirmoi vendimin e 8 shtatorit 2009 të instancës së parë. Aktvendimi në fjalë, përcakton: *“Kreditori (parashtruesja) ka parashtruar propozim në bazë të dokumentit përmbarimor-vendimit të plotfuqishëm nr. 112-158/1 të dt. 12.06.08 i lëshuar nga Komisioni i Ankesave të shërbyesve civilë të Drejtorisë për Administratë dhe Personel i KK Skenderaj”*.
25. DKA në Skenderaj, brenda afatit ligjor, parashtroi ankesë në Gjykatën e Qarkut në Mitrovicë kundër Aktvendimit të 15 tetorit 2009 të instancës së dytë, të Gjykatës Komunale të Skenderajt.
26. Më 19 prill 2010, DKA në Skenderaj u ankua në Zyrën e Prokurorit Disiplinor për shkak se gjyqtari i rastit po e vononte dërgimin e shkresave të lëndës E. nr. 46/2009 të Gjykatës Komunale të Skenderajt, për në Gjykatën e Qarkut në Mitrovicë.
27. Më 27 maj 2010, Zyra e Prokurorit Disiplinor, njofton DKA-në në Skenderaj se ankesa e saj së bashku me shkresat e lëndës janë dërguar në Gjykatën e Qarkut në Mitrovicë, më 21 prill 2010, por që Gjykata e Qarkut në Mitrovicë, më 22 prill 2010, e kishte kthyer lëndën që përkohësisht të qëndronte në Gjykatën Komunale të Skenderajt, deri në krijimin e kushteve normale për punë në Gjykatën e Qarkut në Mitrovicë.
28. Më 13 shkurt 2012, Gjykata e Qarkut në Mitrovicë (Aktvendimi Ac. nr.76/11), e hodhi si të palejuar propozimin e parashtrueses për përmbarim të vendimit të formës së prerë dhe e ndryshoi Aktvendimin e 15 tetorit 2009 të Gjykatës Komunale të Skenderajt, me arsyetimin se *“Në rastet kur organi i punësimit*

përkatës nuk i përmbahet vendimit dhe urdhrorit të Këshillit, Këshilli ia paraqet rastin Kuvendit, i cili ia përcjellë raportin e Këshillit, Kryeministrit të Kosovës.”

29. Më 22 gusht 2012, parashtruesja e kërkesës sërish e njoftoi KPMK-në për mospërmbarimin e vendimit përfundimtar, por që sipas saj, KPMK-ja nuk i është përgjigjur.
30. Më 12 dhjetor 2012, parashtruesja ushtroi padi në Gjykatën Themelore në Mitrovicë, dega në Skenderaj, për realizimin e pagave të papaguara nga DKA-ja në Skenderaj, duke u mbështetur në të drejtën e saj të fituar me vendimin përfundimtar.
31. Më 27 janar 2014, Gjykata Themelore në Mitrovicë, dega në Skenderaj (Aktgjykimi C. nr. 109/2009), e refuzoi si të paafatshme padinë e parashtrueses me arsyetimin se e njëjta e kishte humbur afatin për të kërkuar mbrojtje gjyqësore të të drejtave të saj për shfrytëzimin e mjeteve ligjore me të cilat do t'i realizonte të drejtat e saj të fituara me vendimin përfundimtar. Ky vendim u konfirmua nga Gjykata e Apelit me Vendimin Ac. nr. 1213/2014, të 5 majit 2016 dhe nga Gjykata Supreme me Vendimin Rev. nr. 335/2016, të 14 korrikut 2016.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

32. Sa i përket pretendimeve për shkeljen e nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të Konventës për mosekzekutimin e Vendimit të KASHC-KK në Skenderaj, nr. 112-158/1 të 12 qershorit 2008, nga autoritetet e Komunës së Skenderajt, parashtruesja e kërkesës pretendon: *“Komuna e Skenderajt pa kurrfarë arsyetimi dhe duke e shkelur ligjin ka refuzuar të zbatojë vendimin e vetë nr. 112-158/1, me të cilin vendim e ka aprovuar, si të bazuar, ankesën e palës (parashtrueses) dhe vetë ka konstatuar se palës, marrëdhënia e punës i është ndërprerë pa bazë ligjore dhe e ka obliguar Drejtorinë Komunale të Arsimit që zonjën Sadije Shabani ta sistemojë në shërbimet e administratës komunale.”*
33. Sa i përket pretendimeve për shkeljen e nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të Konventës për mosekzekutimin e Vendimit të KASHC-KK në Skenderaj, nr. 112-158/1 të 12 qershorit 2008, nga gjykatat e rregullta përmbareuese, parashtruesja e kërkesës pretendon se, *“...me një shtet demokratik organet kompetente janë të obliguara që të themelojnë një sistem për zbatimin e vendimeve, i cili është efektiv si në kuptimin ligjor po ashtu edhe në atë praktik ... Po ashtu, konsideroj se një e drejtë e fituar nuk duhet të mbetet vetëm në letër por duhet të realizohet edhe në praktikë ... gjykatat të cilave pala u është drejtuar kanë dështuar që të njëjtës t'i sigurojnë një gjykim të drejtë dhe të paanshëm.”*
34. Sa i përket pretendimeve për shkeljen e të drejtave të mbrojtura me nenin 54 të Kushtetutës, nga gjykatat e rregullta, parashtruesja pretendon se, *“... që nga koha e ndërprerjes së marrëdhënies së punës, në vazhdimësi dhe pa asnjë ndërprerje i ka ndërmarrë të gjitha veprimet juridike dhe veprimet tjera të nevojshme për realizimin e të drejtës së saj të ligjshme dhe të bazuar.”*
35. Përveç kësaj, parashtruesja gjithashtu pretendon se Komuna e Skenderajt dhe gjykatat e rregullta shkelën të drejtën e saj për mbrojtjen e pronës, e cila u garantohet individëve me nenin 46 të Kushtetutës, për shkak të mosekzekutimit

të Vendimit të KASHC-KK në Skenderaj, nr. 112-158/1, të 12 qershorit 2008, nga i cili vendim parashtruesja pretendon se ka pasur pritje legjitime për kompensim të pagave të humbura.

36. Për më tepër, parashtruesja pretendon se Komuna e Skenderajt dhe gjykatat e rregullta me veprimet e tyre shkelën të drejtën e saj të garantuar me nenin 49 të Kushtetutës, për faktin se ajo nuk mund të jetë fajtores për dështimin e organeve kompetente në mbrojtjen e të drejtave të saj të ligjshme, për të punuar dhe për të ushtruar profesionin e saj.
37. Ndër të tjera, parashtruesja e kërkesës kërkon “... nga Gjykata Kushtetuese e Kosovës, ta deklaroj të pranueshme kërkesën tonë, të konstatoj se ka pasur shkelje të nenit 24, nenit 31, nenit 54 dhe nenit 49 dhe 46 të Kushtetutës dhe shkelje të nenit 6 të KEDNj-së...”

Dispozitat e aplikueshme ligjore

Rregullorja e UNMIK-ut 2001/36, 22 dhjetor 2001

(a) “Nëpunës civil” do të thotë çdo person i punësuar i një organi të punësimit, rroga e të cilit paguhet nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës, përveç për (i) anëtarët e Këshillit; (ii) duke përjashtuar personat e emëruar dhe (iii) anëtarët e Trupave Mbrojtëse të Kosovës”.

Neni 11 Apelimi

11.1 Nëpunësi civil i cili është dëmtuar me një vendim të organit të punësimit, duke shkelur parimet e parashtruara në nenin 2.1 të kësaj Rregulloreje, mund t’i ankohet Këshillit për një vendim të tillë në pajtim me dispozitat e këtij neni.

Ligji nr.03/L-008 për Procedurën Përmbarimore

Neni 1 (Përmbajtja e ligjit)

“1.1 Me këtë ligj caktohen rregullat për procedurën e gjykatës sipas të cilës realizohen kërkesat në bazë të titujve ekzekutiv (procedura e përmbarimit), po që se me ligj të posaçëm nuk është paraparë diçka tjetër.

1.2 Dispozitat e këtij ligji zbatohen edhe për përmbarimin e vendimit të dhënë në procedurë administrative dhe për kundërvajtje me të cilin është caktuar detyrimi në të holla, përveçse kur për përmbarimin e tillë është paraparë me ligj kompetenca e organit tjetër”.

Neni 24.1

Tituj ekzekutiv janë:

- a) vendimi ekzekutiv i gjykatës dhe ujdia gjyqësore ekzekutive;
- b) vendimi ekzekutiv i dhënë në procedurë administrative dhe ujdia administrative, po që se ka të bëjë me detyrimin në të holla dhe po që se me ligj nuk është paraparë diçka tjetër;
- c) dokumenti noterial ekzekutiv;
- d) dokumenti tjetër që me ligj është quajtur dokument ekzekutiv.

Neni 26.3

Përmbarrueshmëria e vendimit

Vendimi i dhënë në procedurë administrative është përmbarrimorë, po që se i tillë është bërë sipas rregullave me të cilat është rregulluar procedura e tillë.

Neni 294

Shpërblimi i pagës në rast të kthimit të punëtorit në punë

294.1 Propozuesi i përmbarrimit që e ka parashtruar propozimin për kthim në punë, ka të drejtë të kërkojë që gjykata të nxjerrë aktvendim me të cilin do të caktojë se, debitori ka për detyrë që atij t'ia paguajë në emër të pagës shumë mujore që janë bërë të kërkueshme, nga dita në të cilën ka marrë formë të prerë vendimi e deri në ditën e rikthimit në punë. Me të njëjtin aktvendim, gjykata e cakton përmbarrimin për realizimin e shumëve mujore të caktuara.
294.2 Propozimi për shpërblim mund t'i bashkëngjitet propozimit për përmbarrim, ose mund të paraqitet më vonë deri në përfundimin e procedurës së përmbarrimit.

Neni 295

Efekti i aktvendimit për përmbarrimin

295.3 Shpërblimi i pagës mujore caktohet në shumën që do ta realizonte punëtori po të ishte në punë”.

Pranueshmëria e kërkesës

38. Gjykata do të shqyrtojë nëse parashtruesja e kërkesës i ka plotësuar kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuar më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

39. Gjykata së pari duhet të përcaktojë nëse parashtruesja e kërkesës është palë e autorizuar dhe i ka shterur të gjitha mjetet efektive juridike për të parashtruar kërkesë në Gjykatë, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, që përcakton:

“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

40. Gjykata, me tej, merr parasysh kërkesat e nenit 49 të Ligjit, që përcakton:

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh”.

41. Gjykata, gjithashtu, merr parasysh kërkesat e nenit 48 të Ligjit, që parasheh:

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.”

42. Përveç kësaj gjykata i referohet rregullit 36 (1) (d) të Rregullores, që përcakton se:

*“Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:
(...)”*

d) kërkesa arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar”.

43. Në bazë të kriterëve të mësipërme, Gjykata vlerëson se parashtruesja e kërkesës i ka shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion të parapara me ligjet e aplikueshme dhe, në mungesë të ndonjë mjeti tjetër juridik efektiv, ajo në pajtueshmëri me kërkesat e nenit 113.7 të Kushtetutës i është drejtuar Gjykatës me kërkesë për realizimin e të drejtave të saj të garantuara me Kushtetutë.
44. Gjykata më tej vlerëson se, kriteri për dorëzimin e kërkesës brenda afatit 4 (katër) muaj, në rastin e parashtrueses së kërkesës, nuk është i aplikueshëm sepse kemi të bëjmë me situatë të vazhdueshme të mospërmbarimit të një vendimi përfundimtar të autoritetit publik (shih, *mutatis mutandis*, *Iatridis kundër Greqisë*, nr. 59493/00, GJEDNJ, Aktgjykim i 19 tetorit 2000). GJEDNJ-ja thekson në mënyrë eksplicite, në një situatë të ngjashme që paraqitet në rastin *Iatridis kundër Greqisë*, se rregulli i afatit kohor nuk vlen në rastin kur ekziston refuzimi i ekzekutivit që të pajtohet me vendim konkret.
45. Në të vërtetë, në një situatë të ngjashme, Gjykata i referohet praktikës së saj kur vendosi lidhur me mospërmbarimin e vendimeve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës, vendime të cilat ishin nxjerrë në procedurë administrative, por që për nga natyra zgjidhnin kontestet nga marrëdhënia e punës të nëpunësve civilë. Në këto raste, Gjykata konstatoi ekzistimin e një situate të vazhdueshme, si rezultat i së cilës afati kohor prej 4 (katër) muajsh për dorëzimin e kërkesës në Gjykatë ishte i paaplikueshëm (Shih aktgjykimet e Gjykatës Kushtetuese në rastet K150/12, *Agush Lllolluni*, Aktgjykim i 16 korrikut 2012; KI94/13 *Avni Doli, Mustafa Doli, Zija Doli dhe Xhemile Osmanj*, Aktgjykimi i 24 marsit 2014).
46. Prandaj, afati kohor prej 4 (katër) muajsh në rastin e parashtrueses së kërkesës është i paaplikueshëm për shkak të ekzistimit të situatës së vazhdueshme, e cila ka ardhur si rezultat i mospërmbarimit të vendimit përfundimtar.
47. Gjithashtu, Gjykata vlerëson se parashtruesja e kërkesës ka treguar saktësisht se cilat të drejta kushtetuese i janë shkelur me mospërmbarimin e vendimit të KSHAC-KK në Skenderaj, të 12 qershorit 2008, duke përmendur edhe autoritetet publike që pretendohet se ia mohuan të drejtat e saj kushtetuese.
48. Si përmbledhje, Gjykata konsideron se parashtruesja është palë e autorizuar, i ka shteruar të gjitha mjetet juridike, e ka përmbushur kriterin e afatit, si rezultat i situatës së vazhdueshme dhe ka sqaruar me saktësi shkeljen e pretenduar të të drejtave dhe lirive të saj, si dhe ka përmendur autoritetet publike që pretendohet se shkelën të drejtat e saj.
49. Nga sa u tha më sipër, Gjykata konstaton se kërkesa e parashtrueses i plotëson të gjitha kriteret e pranueshmërisë, prandaj Gjykata më tutje do të vlerësojë meritat e kërkesës.

Vlerësimi i meritave të kërkesës

50. Në këtë rast konkret, Gjykata vëren se kontesti nga marrëdhënia e punës është zgjidhur përfundimisht nga KASHC-KK në Skenderaj, me vendimin e 12 qershorit 2008, sipas procedurës administrative, bazuar në Rregulloren e

UNMIK-ut 2001/36, të 22 dhjetorit 2001, me të cilën rregullohej statusi juridik i nëpunësve civilë. Me këtë vendim, parashtruesja e kërkesës fitoi të drejtën për t'u sistemuar në punë në shërbimet e administratës në Komunën e Skenderajt.

51. Gjykata vëren se të gjitha pretendimet e parashtrueses së kërkesës për shkeljen e të drejtave të saj të garantuara me Kushtetutë dhe me Konventë, kanë të bëjnë pikërisht me mospërmbarimin e vendimit të KASHC-KK në Skenderaj nga vet Komuna e Skenderajt dhe nga gjykatat e rregulltat në procedurë përmbarimore.
52. Në dritën e këtyre rrethanave, parashtruesja e kërkesës në mënyrë legjitime pretendon se është viktimë e shkeljeve të të drejtave themelore të garantuara me Kushtetutë dhe Konventë.
53. Para së gjithash, Gjykata rikujton se neni 53 i Kushtetutës përcakton që *“Të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut”*.
54. Në këtë drejtim, Gjykata do të shqyrtojë meritat e kërkesës vetëm sa i përket shkeljeve kushtetuese të cilat ndërlidhen me mospërmbarimin e vendimit të KASHC-KK në Skenderaj, të 12 qershorit 2008.
55. Në lidhje me këtë, Gjykata i referohet nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të Konventës, që përcaktojnë:

31.1. “Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.”

6 (1) “Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të tij civile ..., çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme”.
56. Nga shkresat e lëndës është e qartë se vendimi i KASHC-KK të Skenderajt, nr. 112-158/1, i 12 qershorit 2008, ishte vendim i përmbarueshëm edhe në gjykatat e rregullta sipas procedurës përmbarimore.
57. Sipas ligjeve të aplikueshme, një vendim bëhet i formës së prerë dhe i ekzekutueshëm, përveç tjerash, dhe në rastin kur palët nuk e atakojnë atë me ankesë në instanca më të larta, siç është rasti me parashtruesen e kërkesës.
58. Nisur nga ky fakt, Gjykata konsideron se vendimi i KASHC-KK të Skenderajt, nr. 112-158/1, i 12 qershorit 2008, përbën çështje të gjykuar (*res judicata*), i cili duhej ekzekutuar nga autoritetet kompetente pa zvarritje të panevojshme në mënyrë që ato (autoritetet) t'i përmbushnin detyrimet e tyre sipas nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të Konventës, që një e drejtë e fituar me një vendim përfundimtar të mos mbetet e parealizuar edhe në kuptimin praktik.
59. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se, parashtruesja e kërkesës shfrytëzoi të gjitha mjetet ligjore në dispozicion në kërkim të përmbarimit të vendimit përfundimtar. Megjithatë, të gjitha mjetet ligjore të shfrytëzuara nga ajo

rezultuan të pasuksesshme dhe joefektive, sepse nuk i ofruan asaj një zgjidhje praktike, siç kërkohet me nenet e sipërcekura.

60. Gjykata, pas analizimit të rrethanave të rastit, konsideron se nuk ka ekzistuar asnjë arsye që autoritetet e Komunës së Skenderajt dhe gjykatat e rregullta në procedure përmbartimore, për më shumë se 8 vite të zvarrisin dhe të refuzojnë ekzekutimin e vendimit të KASHC-KK të Skenderajt, nr. 112-158/1, të 12 qershorit 2008, që kur ky vendim kishte marrë formën e prerë dhe ishte bërë titull i përmbartueshëm, sipas ligjit të aplikueshëm.
61. Në këtë kontekst, Gjykata thekson se, përmbartimi i një vendimi përfundimtar, duhet shikuar si pjesë përbërëse e të drejtës për gjykim të drejtë, që garantohet me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të Konventës. Parimi i lartpërmendur është i një rëndësie të madhe në kuadër të procedurës administrative, në lidhje me një kontest, rezultati i të cilit është i një rëndësie të veçantë për të drejtat civile të palëve në kontest (shih, *mutatis mutandis*, Aktgjykimin e GJEDNJ-së, në rastin *Hornsby kundër Greqisë*, të 19 marsit 1997, raportet 1997-II, f. 510, para. 40. Shih, gjithashtu Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese, në rastin KI112/12 *Adem Meta*, të 5 korrikut 2013).
62. Gjykata rikujton se neni 6 i Konventës zbatohet edhe për fazat administrative të procesit gjyqësor, gjegjësisht është brenda kornizave të procesit të rregullt gjyqësor. Andaj, edhe mospërmbartimi i vendimeve përfundimtare të nxjerra në procedurë administrative është element i nenit 6 të Konventës dhe shkelje e saj (shih, *mutatis mutandis* Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese, në rastin KI47/12, *Isalm Thaçi*, të 11 korrikut 2012, paragrafi 48). Për më tepër, Gjykata thekson se, një vendim përfundimtar i lëshuar nga një organ administrativ i themeluar me ligj, prodhon efekte juridike për palët, dhe si i tillë është dhe i përmbartueshëm (Shih, Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese, në rastin KI04/12, *Esat Kelmendi*, të 20 korrikut 2012).
63. Gjykata vë në pah se e drejta e inicimit të procedurës gjyqësore, në raste civile, siç parashihet me nenet e lartcekura, do të ishte iluzore nëse sistemi juridik i Republikës së Kosovës do të lejonte që një vendim përfundimtar, i formës së prerë, të mbetej i paefektshëm në dëm të një pale. Interpretimi i neneve të lartpërmendura ekskluzivisht ka të bëjë me qasjen ndaj Gjykatës, administrimit dhe efektshmërinë e procedurave gjyqësore. Prandaj, joefektshmëria e procedurave do të na sillte para situatave që nuk janë në përputhje me parimin e sundimit të ligjit, parim të cilin autoritetet e Republikës së Kosovës janë të obliguara ta respektojnë (shih, *mutatis mutandis*, Aktgjykimin e GJEDNJ-së, në rastin *Romashov kundër Ukrainës*, të 25 korrikut 2004, Ankimi nr. 67534/01).
64. Gjykata ripërseritë se sundimi i ligjit është një prej parimeve themelore të një shoqërie demokratike që presupozon respektimin e parimit të sigurisë juridike, sidomos në lidhje me vendimet e formës së prerë, të cilat përbëjnë çështje të gjykuar *res judicata*. Asnjë palë nuk ka të drejtë të kërkojë rishikimin e një vendimi përfundimtar thjeshtë për qëllime të fitimit të rishikimit dhe rishqyrtimit të freskët të rastit (shih, *mutatis mutandis*, rastin *Sovtransavto Holding kundër Ukrainës*, Ankimi nr. 48553/99, paragrafi 72, ECHR 2002-VII, si dhe *Ryabykh kundër Rusisë*, Ankimi nr. 52854/99, paragrafi 52, ECHR 2003-IX).

65. Përveç kësaj, Gjykata thekson se jurisprudenca e GJEDNJ-së, kërkon që një individ i cili ka marrë aktgjykim kundër shtetit në fund të procedurave gjyqësore nuk mund të pritët që ai ose ajo, të iniciojë procedurë të veçantë të përmbarimit (Shih, Aktgjykimin e GJEDNJ-së, në rastin *Burdov kundër Rosisë*, të 15 janarit 2009, Ankimi nr. 33509/04, (nr.2), paragrafi 68). Barra për të siguruar pajtueshmërinë e aktgjykimit kundër shtetit qëndron kryesisht tek autoritetet shtetërore (Shih, Aktgjykimin e GJEDNJ-së, në rastin *Yavorivskaya kundër Rosisë*, të 21 qershorit 2005, nr. 34687/02, paragrafi 25), duke filluar nga dita në të cilën vendimi bëhet i detyrueshëm dhe i zbatueshëm (Shih, *Burdov kundër Rosisë*, Ankimi nr. 33509/04 (nr.2), paragrafi 69).
66. Për më tepër, autoritetet kompetente kanë obligime pozitive që të organizojnë një sistem efikas për zbatimin e vendimeve, që janë efektive në kuptimin ligjor dhe në atë praktik, dhe të sigurojnë që zbatimi i tyre të bëhet pa vonesa të pa nevojshme (shih, *mutatis mutandis*, rastin *Peceve kundër Ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë*, të 6 nëntorit 2008, Ankimi nr. 21839/03; si dhe rastin *Martinovska kundër Ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë*, të 25 shtatorit 2006, Ankimi nr. 22731/02).
67. Sa i përket pretendimeve tjera të parashtrueses së kërkesës për shkelje të neneve 24 dhe, 46, 49 dhe 54 të Kushtetutës, Gjykata nuk e konsideron të nevojshme që t'i trajtojë ato, pasi që ajo tashmë ka gjetur shkelje nga neni 31 i Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të Konventës, sa i përket mospërmbarimit të vendimit të KASHC-KK të Skenderajt, nr. 112-158/1, të 12 qershorit 2008.
68. Si përmbledhje, Gjykata gjen se parashtrueses së kërkesës i janë mohuar të drejtat e saj të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të Konventës, sepse Komuna e Skenderajt dhe gjykatat e rregullta në procedurë përmbarimore për më shumë se 8 (tetë) vite, kanë dështuar në përmbarimin e vendimit të KASHC-KK të Skenderajt, nr. 112-158/1, të 12 qershorit 2008.

Përfundim

69. Gjykata thekson se në praktikën e saj gjyqësore në shumë raste ajo ka konstatuar se çështjet e faktit dhe çështjet e interpretimit dhe zbatimit të ligjit janë brenda domenit të gjykatave të rregullta dhe të autoriteteve të tjera publike, në kuptim të nenit 113.7 të Kushtetutës dhe si të tilla janë çështje të ligjshmërisë, përveç dhe përderisa, çështje të tilla rezultojnë në shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut ose krijojnë një situatë antikushtetuese. Pra, Gjykata ka obligim kushtetues që të sigurojë se në procedurat e mbajtura para autoriteteve publike janë respektuar të drejtat themelore të njeriut dhe epërsia e Kushtetutës.
70. Si përfundim, nga të gjitha arsyet e shtjelluara më lart, Gjykata konstaton se dështimi i autoriteteve kompetentë të Republikës së Kosovës për të siguruar mekanizma efikas në kuptim të përmbarimit të vendimit përfundimtar që ishte bërë *res judicata* është në kundërshtim me parimin e sundimit të ligjit, sigurinë juridike dhe përbën shkelje të të drejtave themelore të njeriut të garantuara me Kushtetutë dhe Konventë.

71. Rrjedhimisht, Gjykata konkludon se, mospërmbarimi i Vendimit të Komisionit të Ankesave të Shërbyesve Civilë të Komunës së Skenderajt, nr. 112-158/1, të 12 qershorit 2008 nga vet Komuna e Skenderajt dhe nga ish Gjykata e Qarkut në Mitrovicë, shkel të drejtat e parashtrueses së kërkesës të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të Konventës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, me nenin 20 të Ligjit dhe me rregullin 56 (1) të Rregullores së punës, në seancën e saj të mbajtur më 13 nëntor 2017, njëzëri:

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të pranueshme;
- II. KONSTATON se ka pasur shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të Konventës;
- III. TË DEKLAROJË se Vendimi i Komisionit të Ankesave të Shërbyesve Civilë të Komunës së Skenderajt, nr. 112-158/1, i 12 qershorit 2008, përbën çështje të gjykuar *res judicata* i cili duhet të ekzekutohet nga Komuna e Skenderajt;
- IV. TA DEKLAROJË të pavlefshëm vendimin e ish-Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë, Ac. nr. 76/11, të 13 shkurtit 2012, DHE T'IA KTHEJË Gjykatës së Apelit lëndën e parashtrueses në procedurë përmbartimore për shqyrtim në përputhje me Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese, gjegjësisht të merr parasysh se Vendimi i Komisionit të Ankesave të Shërbyesve Civilë të Komunës së Skenderajt, nr. 12-158/1, i 12 qershorit 2008, duhet të përmbahet në afatet e përcaktuara me ligj;
- V. T'UA PËRKUJTOJË organeve kompetente obligimet e tyre, në pajtim me nenin 116 [Efekti Juridik i Vendimeve] të Kushtetutës dhe me rregullin 63 [Zbatimi i vendimeve] të Rregullores së punës së Gjykatës;
- VI. T'IA PËRKUJTOJË Komunës së Skenderajt dhe Gjykatës së Apelit që në pajtim me rregullin 63 (5) të Rregullores së punës, të dorëzojnë informacione në Gjykatën Kushtetuese në lidhje me masat e ndërmarra për zbatimin e Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese, në afat prej 6 (gjashtë) muajsh;
- VII. TË NJOFTOJË palët lidhur me këtë aktgjykim dhe ta publikojë atë në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese;
- VIII. Ky aktgjykim do të ketë efekt të menjëhershëm.

Gjyqtarja raportuese

Selvete Gërxhaliu-Krasniqi



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Arta Rama-Hajrizi